



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:066020
Datë: 28.02.2025
Numri i dokumentit: 06923727

C.nr.320/23

GJYKATA THEMELORE GJILAN, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Laureta Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Z.F., dhe Z.F., që të dy nga fshati P., komuna e P., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Rustem Latifaj avokat në Gjilan, kundër të paditurve B.F., nga fshati P., i përfaqësuar me autorizim nga Faruk Brestovci avokat në Gjilan, D.F., M.F., dhe S.F., që të gjithë nga fshati P., komuna e P., të cilët me autorizim i përfaqëson Faruk Brestovci, avokat në Gjilan, me objekt kontesti vërtetim i pronësisë, më datë 25.02.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësve Z.F., dhe Z.F., që të dy nga fshati P., komuna e P. kundër të paditurve B.F., D.F., M.F., dhe S.F., me objekt kontesti vërtetim i pronësisë.

A r s y e t i m

Paditësit Z.F., dhe Z.F., nga fshati P., komuna e P., më datë 15.03.2023 kanë parashtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurve B.F., D.F., M.F., dhe S.F., që të gjithë nga fshati P., komuna e P., me objekt kontesti vërtetim i pronësisë.

Lidhur me këtë, gjykata e ka caktuar seancën përgatitore për datë 25.02.2025, në të cilën nuk ka prezantuar përfaqësuesi i paditësve, i cili më datë 25.02.2025, në këtë gjykatë ka parashtruar parashtrësën, me të cilën ka tërhequr padinë. Meqë përfaqësuesi i të paditurit B.F., ka dorëzuar përgjigje në padi, përfaqësuesi i tij, avokati Faruk Brestovci dhe nuk e ka kundërshtuar padisë. Të paditurit e tjerë që ishin prezent, nuk kanë dorëzuar përgjigje në padi, por u deklaruan se nuk kundërshtojnë tërheqjen e padisë.

Sipas nenit 261.2 të LPK-së, padia mund të tërhiqet edhe më vonë nëse për këtë jep pëlqim i padituri, andaj, gjykata, duke u bazuar edhe në nenin 387.1 nën pika c) dhe 142 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjyqtari,

Arben Xheladini

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.